

Data: 08-07-2026

Numri: 12 –

Shkup

Drejtuar: ISHP/ISHP (private) _____

Lënda: Njoftim

Të nderuar,

Në lidhje me Vendimet për ndryshimin dhe plotësimin e Listës së barnave që mbulohen nga FSSHRMV-ja, të publikuara në Gazetën Zyrtare të RMV-së nr. 128 datë 12.06.2026, Korrigjimi i Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Listës së barnave që mbulohen nga FSSHRMV të publikuara në Gazetën Zyrtare të RMV-së, nr. 144 datë 01.07.2026 dhe njoftimi i Fondit me nr. 15-13451/1 datë 30.06.2026 dorëzuar te të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private, Ju informojmë si në vijim:

Për barnat **Enoxaparin (injeksione/tretje për injektim) dhe Nadroparin (injeksione/tretje për injektim)**, si dhe për të gjitha barnat tjera nga Lista e barnave që mbulohen nga Fondi, mjekët specialistë/subspecialistë gjatë lëshimit të raporteve dhe fletë-lëshimeve nevojitet në mënyrë të rregullt dhe në tërësi t'i plotësojnë të gjitha fushat e formularëve përkatës, me anë të së cilës dhënien e rekomandimit për terapi me këto barna duhet ta kryejnë me vendosjen e emrit gjenerik të barit, formën e dozimit farmaceutik dhe forcën.

Mjekët spspecialistë/subspecialistë gjatë lëshimit të rekomandimit për terapi që mbulohen nga Fondi me barnat **Enoxaparin (injeksione/tretje për injektim) dhe Nadroparin (injeksione/tretje për injektim)**, të cilat në Listën e barnave janë me regjim të përshkrimit RS (me rekomandim të mjekut specialistë), nevojitet t'i respektojnë indikacionet të cilat për këto barna janë të përcaktuara me Vendimet e lartpërmendura për ndryshimin dhe plotësimin e Listës së barnave që mbulohen nga FSSHRMV (Shtojca 1).

Për barin **Rivaroxaban** (tabletat), me regjim të përshkrimit RS (me rekomandim të mjekut specialist), theksojmë se me Korrigjimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Listës së barnave që mbulohen nga FSSHRMV, e publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV-së nr. 144 datë 01.07.2026, MKB-10 shifra e diagnozës I74 është fshirë, dhe për këtë bar nevojitet nga ana e mjekëve specialist/subspecialistë, gjatë dhënies së rekomandimit për terapi me këto barna që mbulohen nga Fondi, të respektohen indikacionet të cilat për këtë barë janë të përcaktuara me Vendimin për

ndryshimin dhe plotësimin e Listës së barnave që mbulohen nga FSSHRMV (Shtojca 2).

Gjatë përshkrimit të barnave: Enoxaparin (injeksione/tretje për injektim), Nadroparin (injeksione/tretje për injektim) dhe Rivaroxaban (tableta), në recetë që mbulohen nga Fondi, nga ana e mjekëve të zgjedhur duhet të respektohen indikacionet për të cilat është dhënë rekomandim për terapi me këto barna nga ana e mjekëve specialistë/subspecialistë, por ndërkohë të kihet kujdes këto indikacione të jenë në pajtim me indikacionet për këto barna të përcaktuara me Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Listës së barnave që mbulohen nga FSSHRMV.

Barnat Enoxaparin (injeksione/tretje për injektim) dhe Nadroparin (injeksione/tretje për injektim), janë të përfshira me Vendimin e Bordit drejtues të Fondit për plotësimin e Vendimit për përcaktimin e barnave, pakot origjinale të së cilave ndahen me nr. 02-13421/2 datë 29.06.2026, që është e publikuar në ueb faqen e Fondit (link: zo.org.mk/odluki-za-utvrduvane-na-lekovi-chii-originalni-pakuvana-se-delat). Në pajtim me Vendimin, barnat janë të përfshira me këtë vendim përshkruhen dhe lëshojnë sipas njësisë së formës së dorëzimit farmaceutik.

Këto barna në recetë, mjeku i zgjedhur mund t'i përshkruajë sipas njësisë së formës së dozës farmaceutike, por në një recetë më së shumti deri në sasinë e formave të njëjta të dozës (injeksione) të këtyre barnave në një paketim origjinal. Sot, emrat mbrojtës për barnat Enoxaparin (injeksione/tretje për injektim) dhe Nadroparin (injeksione/tretje për injektim), që janë të përfshirë me këtë Vendim janë në paketimin origjinal prej 10 injeksione.

Shembull: nëse mjeku i zgjedhur nevojitet personit të siguruar t'i përshkruajë cilëndo qoftë nga barnat e përmendura në sasi prej 18 injeksione, në këtë rast të mjeku i zgjedhur barin e përshkruan në dy receta, prej të cilave në njërin recetë barin e përshkruan në sasi 10 forma-injeksione të vetme të dozimit farmaceutik, ndërsa në recetën e dytë barin e përshkruan në sasi prej 8 formave-injeksioneve të vetme të dorëzimit farmaceutik.

Mjeku i zgjedhur gjatë përshkrimit të barit Enoxaparin (injeksione/tretje për injektim) dhe Nadroparin (injeksione/tretje për injektim), në recetë që mbulohen nga Fondi, si dhe për të gjitha barnat e tjera nga Lista e barnave që mbulohen nga Fondi, për kujdesin shëndetësor primar, nevojitet të shënohet edhe një nga fushat: A – barna për sëmundje akute dhe X – barnat për sëmundje kronike, në varësi nga lloji i sëmundjes, rekomandimi për terapi është dhënë nga mjeku specialistë/subspecialistë dhe kohëzgjatja e terapisë.

ISHP barnatoret barnat Enoxaparin (injeksione/tretje për injektim) dhe Nadroparin (injeksione/tretje për injektim), duhet t'i lëshojnë në recetë që mbulohen nga Fondi, si dhe të gjitha barnat nga Lista e barnave që mbulohen nga Fondi, për kujdesin shëndetësor primar, në mënyrë që është në pajtim me treguesin për terapi për sëmundje akute ose kronike, të shënuar nga ana e mjekut të zgjedhur.

Me respekt,

Drejtör,
Sasho Klekovski

Përpiloi: Irena Barutoska

Me pëlqim të: ekon. dipl. Samir Neziri

Miratoi: dr. Sillvana Andov

Shtojca 1: Indikacione për Enoxaparin dhe Nadroparin

- Profilaksa e sëmundjeve tromboembolike të venave tek pacientët kirurgjik me rrezik mesatar dhe të lartë, në veçanti tek ata të nënshtruar në intervenim të përgjithshëm kirurgjik, duke e përfshirë kirurgjinë e kancerit.
- Profilaksa e sëmundjeve tromboembolike të venave tek pacientët me sëmundje akute (siç janë dobësia akute e zemrës, insuficienca respiratore, infeksionet e rënda ose sëmundjet reumatike) dhe tek pacientë me lëvizshmëri të zvogëluar gjatë rrezikut të rritur nga tromboembolia venoze.
- Trajtimi i trombozës së thellë venoze (TTHV) dhe embolizmi pulmonar (EP) me përjashtim të embolizmave pulmonare për të cilët me siguri nevojitet terapia trombolitike ose intervenca kirurgjike.
- Trajtim i vazhduar i trombozës së thellë venoze (TTHV) dhe embolizmi pulmonar (EP) dhe parandalimi i thirrjeve të përsëritura të tyre tek pacientët me kancer aktiv.
- Parandalimi i formimit të trombëve tek qarkullimi ekstrakorporal gjatë hemodializës
- Sindromi akut koronar:
- Trajtimi i anginës jostabile ose infarkti akut miokard pa vlerësim të ST segmentit (NSTEMI), në kombinim me aplikim peroral të acidit acetilsalicilik.

- Trajtim i infarktut akut i miokardit me lartësi të ST-segmentit (STEMI), duke i përfshirë pacientët që duhet të trajtohen me trombolitike ose tek të cilët duhet të zbatohet ndërhyrje pasuese koronare perkutane (PCI).

Shtojca 2: Indikacione për Rivaroxaban

10 mg film tableta të paketuara:

- Parandalimi i tromboembolizmit venoz (TEV) tek pacientët e rritur të nënshtruar në zëvendësim selektiv të ijës dhe gjurit
- Terapia e trombozës së thellë venoze (TTHV) dhe embolizmi pulmonar (EP) dhe parandalimi i TTHV rekurent dhe EP, tek të rriturit 15 mg dhe 20 mg tableta të paketuara:
- Parandalimi i goditjes në tru dhe embolizmi sistematik tek pacientët e rritur me fibrilacion atrial jovalvular me një ose më shumë faktorë të rrezikur, siç janë dobësia kongestive e zemrës, hipertension, moshë ≥ 75 vite, diabetes melitus, goditje e mëparshme në tru ose goditje ishemiike tranzistuese.
- Terapia e trombozës së thellë venoze (TTHV) dhe embolizmit pulmonar (EP) dhe parandalimi i TTHV rekurent dhe EP), tek të rriturit (për pacientë me EP jostabile hemodinamike).

Popullata pediatrike:

- 15 mg dhe 20 mg tableta të paketuara: terapia e tromboembolizmit venoz (TEV) dhe parandalimi i TEV rekurent tek fëmijët dhe adoleshentët në moshë nën 18 vjeç dhe me peshë prej 30 deri 50 kg pas minimumi 5 ditë nga terapia fillestare me antikoagulantë parenteral
- 20 mg tableta të paketuara: terapia e tromboembolizmit venoz (TEV) dhe parandalimi i TEV rekurent tek fëmijët dhe adoleshentët në moshë nën 18 vjeç dhe me peshë mbi 50 kg pas minimumi 5 ditë nga terapia fillestare me antikoagulantë parenteral.